

AUTORITETI PORTUAL I DURRËSIT NË SIMPOZIUMIN SHKENCOR PËR SISTEMIN DETAR Vlorë, 14-15 maj 2010

Autoriteti Portual Durrës APD mori pjesë në 14-15 Maj 2010 në Simpoziumin Shkencor me temë: “Përmirsimi i Sistemit Detar në Shqipëri dhe Përvoja Evropiane”, që u mbajt në Universitetin e Vlores, (Fakulteti i Shkencave Teknike) dhe u organizua nga Departamenti i Shkencave Nautike dhe Departamenti i Inxhinierisë Mekanike dhe Navale të këtij Fakulteti.

Në këtë simpozium mori pjesë Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Portit të Durrësit, Eduard Ndreu i cili në ditën e parë të takimit bëri beri nje prezantim prej 15 minutash të Portit të Durrësit.

Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie ishte “Evidentimi i pikave të dobëta në sistemin detar shqiptar dhe përmirësimi i tyre” si dhe raporti për realizimin e detyrave që ngriti Simpoziumi i I.

Në këtë Simpozium shkencor vemendja u përqëndrua tek gjendja aktuale e detarise, pikat e saj të dobëta dhe të forta si dhe hartimi i një strategjie për përmirsimin e këtij sistemi në përputhje me kërkesat e organizmave ndërkombëtare të detarisë.

Të pranishëm të tjerë ishin përfaqësues të Drejtorisë së Transportit Detar prane MPPT; Ministrisë së Ekonomisë; nga Forcat Detare, Instituti i Transportit, Administrata Detare Suedeze, Universiteti Parthenope i Napolit (Itali), Universiteti i Detarisë i Kostancës (Rumani), Autoriteti Portual i Brindizit (Itali), Organizata Detare e Mesdheut (IMAM), Universitete Detare Turke, Greke dhe Italiane, përfaqësues nga Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve dhe degët e saj në Vlorë, Durrës, Shëngjin dhe Sarandë, Shërbimi Hidrografik Shqiptar, drejtues nga Agjensi Detare nga Vlora dhe Durrësi, Universiteti Botëror i Detarisë Suedi, Përfaqësues të Universiteteve të ndryshme Shqiptare.



